

E MËRKURA E MADHE. Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht.



E mërkurë, 12 prill 2023 – Kujtimi i ditës.

JAVA E MADHE E PASHKËS – KRESHMË

E MËRKURA E MADHE. Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht.

– Lyerja e këmbëve të Zotit Krisht –

Të Mërkurën e Madhe përkujtojmë lyerjen me miro të këmbëve të Zotit tonë Jisu Krisht nga gruaja e përdalë. Gjithashtu përkujtojmë edhe mbledhjen e judenjve për të akuzuar Zotin Krisht nëpërmjet nxënësit të Tij, Juda Iskariotit.

Dy ditë para Pashkës, kur Krishti kishte shkuar në Jerusalem, dhe gjendej në shtëpinë e Simon lebrozit, iu afrua një grua e përdalë edhe ia lau këmbët Krishtit me miro të shtrenjtë dhe ia fshiu me flokët e saj. Miro kishte aromë të mrekullueshme dhe çmimi i miros ishte shumë i shtrenjtë rreth 30 dinarë. Për këtë

nxënësit u habitën, sidomos Juda.

Apostujt e dinin gjithashtu se sa shumë zell kishte Krishti për lëmoshën ndaj të varfërve. Kjo grua leu me miro këmbët e Krishtit për ndjesë të mëkateve edhe Perëndia i fuqishëm i zgjidhi asaj mëkatet e shumta pas aktit të pendesës.

[Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë](#)